



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 33/2010

Prishtinë, 21. 09. 2010, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, Adem Grabovci, Qamile Morina dhe Zef Morina dhe deputetet Emrush Xhemajli dhe Bujar Dugolli.

Munguan: Murselj Haljilji, Adem Salihaj dhe Múfera Şinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Sabit Gashi- MEM; Liridon Mavriqi, Arsim Bruçaj – MEF; Haxhi Gashi- USAID; Saniye Berisha – OSCE, Besim Zeqiri –ICO; Besnik Ramadanaj – KDI; Milazim Allshiqi, dhe Ramadan Makolli – SP-PTK dhe Teuta Pula PTK.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të datës 14.09.2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.03/L-184 për energjinë;
4. Rishqyrtimi i Propozim – Vendimit të Qeverisë për Privatizimin e PTK –së nr. 03 -V-393 datë 27.07.2010;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.03/L-244 për Rezervat shtetërore të mallrave;
6. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 14. 09. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 14. 09. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.03/L-184 për Energjinë;

Kryetarja –Theksoi se për këtë Projektligj është raportues Ethem Çeku, dhe ja dha fjalën.

Ethem Çeku--Tha që grupi punese i ka përfunduar diskutimet që kanë të bëjnë me amendamentet e projektligjit për energjinë. Theksoj që është një projektligji relativisht i mirë që duhet të procedohet në Kuvend me ndryshimet që kanë pësuar gjatë diskutimit që i kemi pasur me të gjitha palët e interesit, në këtë rast dhe me MEM, ZRRE-n, ka pasur shumë diskutim rreth raporteve, dhe përgjegjësi të këtyre institucioneve se në cilat fusha duhet ta mbikëqyrin zbatimin e ligjit. Në i kemi inkuorporuar dhe një pjesë të mirë të amendamenteve të cilat i ka propozuar dhe Komisioni Evropian, apo Sekretariat për Energji në seli në Vjenë, siç jeni dhe ju të informuar dhe ata kanë sjellur amendamentet për projektligjin për energjinë. Po ashtu kemi pasur një bashkëpunim dhe ndihmë të madhe të këshilltareve të USAID-it në këtë projektligj. Tha që beson se grupi punese e ka përfunduar punën e vetë dhe kërkon që të aprovohet ky projektligji për energjinë, dhe që të shkon sa më shpejt në seancë plenare që të arrihen objektivat, dhe dy projektligjet e tjera që janë pako janë para përfundimit që brenda muajit shtator të aprovohen, siç është kërkuar dhe nga Kryetari i Kuvendit që në raportin e progresit të përfshihen dhe këto projektligje në pako.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohej Raporti me amendamente i Projektligjit Nr.03/L-184 për Energjinë për miratim të mëtutjeshme në Komisionet e përherëshme.

4. Rishqyrtimi i Propozim – Vendimit të Qeverisë për Privatizimin e PTK –së nr. 03 -V-393 datë 27.07.2010;

Kryetarja – Fillimisht i njoftoj anëtarët e komisionit me një kërkesë që ka ardhur nga Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave, Kryesues i Komisionit Qeveritar për privatizimin e PTK- së. Që i është drejtuar z, Jakup Krasniqi Kryetari i Kuvendit të

Republikës të Kosovës që Kuvendi ne seancën plenare ne bazë të sqarimeve te dhëna te cilat kanë ardhur nga komisioni qeveritarë ta miratoje këtë vendim. Andaj ne si komision funksional jemi te obliguar ne bazë te përgjegjësiwe që kemi t'i rishqyrtojmë sqarimet për privatizimin e PTK-së. Pastaj te i'a paraqesim Kuvendit rekomandimet.

Fatmir Rexhepi - Tha që është e jona si komision dhe deputet te japim kontributin lidhur me strategjinë që e ka ofruar Qeveria për privatizimin e një kompanie siç është PTK-ja dhe është më interes i përgjithshëm që të përfundojmë këtë proces, dhe t'i vazhdojmë reformat për transformimin e kompanive publike ne këtë rast të PTK-së. Andaj partneriteti publiku privat duhet të jetë dhe në këtë kompani. Ne kemi nevojë të japim një perspektiv për konkurrencë të plotë dhe të këtë transparencë për ruajtjen e kapitalit. Vlera e aksioneve të mbrojtura ne strategji ka vlere te madhe, prandaj strategjia e Qeverisë për privatizimin e PTK-së na orienton por ka nevojë për ndryshim, dhe duhet ta gjejmë një formulim ma te mirë. Konkretisht komisioni duhet t'i thotë po privatizimit të PTK-së. Propozoj që ne njërën prej rekomandimeve të Komisionit që duhet të fillohet me 55% te privatizimit te aseteve të PTK-së që të menaxhohet më mirë. Ndresa sa i përkët mjeteve financiare e të grumbulluara propozoj që këto të shkojnë në dy drejtime pjesa e pare 50% të shkoj për infrastrukturën rrugorë (autostradën) dhe pjesa e dytë 50% të shkoj në për shëndetësinë, arsimin, dhe sektorët e tjerë te zhvillimit ekonomik.

Kaqusha Jashari – tha se detyrë e jonë si komision nuk është të diskutojmë vetëm për PTK-n por për strategjinë e privatizimit dhe te gjinden modalitet se te shkohet me këtë proces. Tha që nuk pajtohet të shkohet me 75% dhe ne strategji dhe ne sqarimi që i kanë dhënë komisioni qeveritare për privatizimin PTK-së nuk po shihet që janë bindëse dhe nuk ka do një argument. Por Kuvendi duhet gjatë shqyrtimit të merre për baze rekomandimit e komisionit. Për menaxhimin dhe përdorimin e mjeteve të cilat i marrim nga privatizimi i PTK-së, propozoj që të shpenzohen vetëm për shpenzime kapitale, e jo ne fusha tjera, që nuk krijojnë do një perspektiv për zhvillimin ekonomik. Ndërsa këto ne strategji nuk është që PTK-ja kur te privatizohet të punësoj punëtor, andaj ne duhet ne duhet që ta rregullojmë dhe ne strategji mirë çështjen e punëtoreve.

Qamile Morina - tha që në si deputet e kemi përgjegjësit për zbatimin e ligjeve, dhe ne këtë rast Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave, nuk po e zbaton ligjin, të neni 9 i ligjit për ndërmarrjet publike është shkelur ligji kur është punuar strategjia për privatizimin PTK-së. Ne dimë Njësia Politike për Monitorimin e planit të biznesit për ndërmarrjet publike, nuk po e zbatojnë ligjin dhe nuk ka monitoruar ndërmarrjet publike. Andaj strategjia për privatizimin e PTK-së duhet të ndalët, një herë. Ne duhet ta kemi mendimin e eksperteve së çka përfitojmë nga privatizimi i PTK-së. Theksoj nuk e kemi ndarjen e qartë të privatizimi nga posta dhe telekomi. Për mjete e privatizimit duhet të krijohet një plani i biznesit qartë se ku duhet të investohet, dhe te gjitha këto çështje duhet të rregullohen.

Emrush Xhemajli (deputet i pavarur) - Tha që ne kemi bërë debat ne Kuvendin e Kosovës, dhe nuk kemi marr vendim ne seance plenare që të fillohet me procesin privatizimit të PTK-së. Në këtë rast është shkelur rregullorja e punës së Kuvendit te neni 65 ku janë të përcaktuar rregullat e punës së komisioneve parlamentare, sepse vetëm për

projektiligje përcaktohet që të shkohet me dy lexime. E dyta është që këtë sqarimin që na kanë sëllirë komisioni qeveritar për privatizimin PTK-së, nuk janë përfshirë vërejtjet e deputeteve gjatë diskutimit në seancën plenare të datës 27 korrik 2010 por vetëm te Ministrit Shala.

Adem Grabovci - tha që ne kemi debatuar gjërë gjatë për modalitetet e privatizimit të PTK-së dhe pastaj është marruar vendim për nisjen e procesit të privatizimit. Theksoj që ne si shtet jemi përcaktuar për ekonominë tregut të lirë. Ne të gjithë e dimë që kjo ndërmarrje publike ka qenë e suksesshme po rrethanat ekonomik dhe proceset që po ndodhin në vendet e tranzicionit dhe ekspertet e kanë rekomanduar që të fillohet me privatizimin PTK-së. Theksoj që ne si komision jemi të obliguar të nxjerrim rekomandimet pastaj i Kuvendi e merr vendimin. Të përqindja tha se në qoftë shkohet me 50% mund të mos kemi investitor serioz. Për punëtorët duhet të këtë kujdes se brenda cilit afat kohorë, Kompania që e privatizon nuk ka të drejtë t'i largon nga puna dhe për këtë çështje duhet të marrim masa preventive në strategji dhe ne si komision duhet të cekure në rekomandime. Ndërkaq për mjetet e privatizimit se si do të shpenzohen i arsyetoj që pjesa më e madhe të shkojnë për infrastrukturë rrugore, sepse ne si shtet duhet të krijojmë kushtet e infrastrukturës rrugore për një zhvillim ekonomik.

Zef Morina - tha që në materialin që ka sjellë komisioni Qeveritar për privatizimin PTK-së nuk janë marr disa vërejtje për bazë që i kemi diskutuar në seancën plenare. Andaj na mbete ne si komision funksional që përsëri me anë të rekomandimeve t'i paraqesim. Të përqindja propozoj që të shkohet më 51% kështu që fuqia vendimmarrëse i kalon kompanisë, lidhur më atë që është propozua për 75% që do të privatizohet PTK-ja pastaj vetëm Posta të rikthehet përsëri si kompani publike, këtu del se po privatizohet telekomi 100%. Prandaj është më mirë që të fillohet me 51%. Për kodin shtetëror dhe kjo çështje duhet të rregullohet sa më shpejtë nga Qeveria apo Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit sepse deri tani siç dihet PTK-ja ka paguar shumë shtrejtë kodet e huaj. Prandaj zgjedhje e problemit të kodit shtetëror e rrit vlerën e shitjes së çmimit të PTK-së.

Myzejne Selmani- tha që ne si grup parlamentar jemi për privatizimin e PTK-së por jo më këtë model. Ne jemi për ekonomi të tregut të lirë, por nuk jemi pyetur dhe as nuk kemi qenë të ftuar ne si komision funksional parlamentar për bashkëpunim për strategjinë nga komisioni qeveritar për privatizimin e PTK-së. Por as që është zhvilluar ndonjë një debat i mirëfilltë se si të gjinden modelet më të mira për Kosovën. Dhe në fund vendimi është dhënë nga Qeveria e jo nga Kuvendi e as Komisioni. Këtë po e shohim në bazë të sqarimeve të cilat na kanë ardhur nga komisioni qeveritar për privatizimin e PTK-së.

Sala Berisha –Shala - Tha që në diskutimin nga seanca plenare në parim ka dalë që po pajtohem për privatizimin e PTK-së. Dhe tani vetëm na duhet të kemi kujdes si ta gjejmë modelin më të përshtatshëm për Kosovën. Andaj ne kemi obligim dhe përgjegjësi në bazë të rregullores së punës së Kuvendit si komisioni funksional t'i paraqesim Kuvendit rekomandimet për shqyrtim dhe pastaj në seancën plenare merren vendimet.

Bujar Dugolli (deputet i pavarur) – tha se konsideroj së për çështje madhor duhet të jemi opozita dhe pozita, në një fjalë dhe për këtë qëllim roli i Kuvendit dhe komisionit është vendimmarrës. Tha që Kosova është futur në ekonominë tregut të lirë dhe ikja nga këto përvojë nuk është mirë për vendin. Andaj duhet të ndodhe privatizimi dhe i ndërmarrjeve publike në këtë rast dhe i PTK-së. Lidhur se çka do të ndodhe me punëtorët kur të privatizohet ai sugjeroi që dhe punëtorët të jenë aksionare me 20% ashtu siç ka ndodhur dhe më privatizimin e disa ndërmarrjeve shoqërore. Shtoj se ky model në fund të fundit është varianti më mirë për punëtorët. Propozoj që komisioni duhet të jetë pjesë e bashkëpunimit me më komisionin qeveritare të Qeverisë për përgatitjen e privatizimit të PTK-së.

Milazim Allshiqi (SP-PTK-së) - tha që PTK-ja është ndërmarrja publike më profitabile që ka së shumti i ka kontribuar buxhetit të Kosovës. Andaj në SP-PTK-së, jemi që të privatizohet PTK-ja por me ligje të mira ku i mbrohen dhe ruhen interesat e punëtorëve. Dhe nuk ka arsyeshmëri ekonomike të argumentuar për privatizim me këtë strategji. Dhe i njoftoj anëtarët e komisionit që sindikata e punëtorëve të PTK-se i ka paditur në gjykatën supreme të Kosovës, Komitetin drejtues të privatizimit të PTK-së.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

- I. Shtyhet shqyrtimi Propozim – Vendimit të Qeverisë për Privatizimin e PTK –së për mbledhjen e radhës;*
- II. Mbledhja e Komisionit të mbahet më dritë të mbyllura në përputhje me Rregulloren e Kuvendit*

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.03/L-244 për Rezervat shtetërore të mallrave;

Kryetarja- tha që tani më rregulloren e re të Kuvendit është rregulluar që projektligjet të shqyrtohen dhe në parim të parë nëpër komisione parlamentare, para së të kalojnë në lexim të parë në seancën plenare.

Pas debatit të gjerë Komisioni miratoi në parim këtë projektligj dhe njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Kuvendi i Kosovës të miratojë në parim Projektligji nr.03/L-244 për Rezervat shtetërore të mallrave

6. Të ndryshme

Kryetarja- propozoj të caktohen grupet e punës për projektligjet të cilat janë në procedurë që të amendamentohen sa më shpejtë që është e mundur..

Për projektligjin për Rezervat Shtetërore të Mallrave nr.03-L-244 u caktuan në grupin e

punese: Ethem Çeku, Adem Grabovci, Myzejene Selmani dhe Zef morina.

Për Projektligjin për *Mbrojtjen e Konkurrencës nr.03-L-229* u caktuan ne grupin punese: Sala Berisha-Shala, Qamile Morina dhe Myzejene Selmani.

Për Projektligjin për *Tregtinë e Mallrave Strategjike nr.03-L-232* u caktuan ne grupin punese: Ethem Çeku, Myzejene Selmani, Fatmire Rexhepi dhe Adem Grabovci.

Për Projektligjet për *Dizajnin Industrial nr.03-L-240; Markat Tregtare nr.03-L-234 ; Metrologjinë nr.03-L-203* u caktua Fatmir Rexhepi dhe Adem Salihaj.

Për projektligjin për *Ndryshimin dhe Plotësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03-L-205* ne grupin punese u caktuan: Myzejene Selmani dhe Kaqusha Jashari

Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani